



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 13.01.2017

Vendim
Nr. 02, datë 13.01.2017

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR PUBLIKIME TË PLOTA
UNIVERSITARE
(TEKSTE UNIVERSITARE, MONOGRAFI DHE CIKLE LEKSIONESH)

Në mbështetje të pikave *j* dhe *k* të nenit **38** të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Senati akademik

VENDOSI:

1. **Tekstet mësimore universitare** të hartuara nga pedagogë të UV-së për një disiplinë të caktuar janë rezultat i një eksperience të gjatë akademike, kërkimore, shkencore e pedagogjike të pedagogut si autor. Ato duhet të reflektojnë njohje të thellë shkencore të objektit të disiplinës, karakter të spikatur pedagogjik, bashkëkohësi shqyrtimi dhe analize si dhe mendim të pavarur origjinal të autorit, në raport me botime paralele.
2. Tekstet duhet të jenë të zhveshura nga plagjiatura, kriptoplajitura dhe shfrytëzimi i punës së autorëve të tjerë, qoftë në mënyrë të hapur qoftë përmes dinakërisë intelektuale. Tekstet mësimore universitare janë punë origjinale të pedagogut si autor, kontribute të qarta kërkimore-shkencore, në të cilat duhet të dëshmohen qartazi mendimi shkencor personal, opoenca dhe polemika shkencore individuale ndaj tezave të mëparshme me të cilat autori nuk është dakord, prurjet dhe risitë personale si dhe përgjegjësitë shkrimit individual, citimit, referimit, literaturës, analizës, konkluzioneve, rekomandimeve etj.
3. Në strukturën e vetë tekstet mësimore universitare respektojnë jorigorozisht temat e ligjëratave dhe skenarin e seminareve sipas parashikimeve në programin mësimor të lëndës dhe sidomos në syllabuset përkatëse.
4. Tekstet mësimore universitare mund të jenë punë individuale ose punë me bashkautorësi. Ato nuk u adresohen vetëm studentëve por më së shumti një auditori më të gjerë specialistësh, ekspertësh dhe rretheve shkencore elitare.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

5. **Monografitë** (studimet monografike) janë punë rreptësisht individuale. Ato trajtojnë zakonisht një çështje të vetme ose disa çështje të përafërta dhe të izoluar nga fusha e studimit të pedagogut apo lëndës/ disiplinës/modulit që ai zhvillon. Monografitë janë njësi shkencore më të vogla se Tekstet universitare, me pretendime shkencore për tema të të veçanta/pjesëshme dhe jo tërësore që të rrokin gjithë tematikën/strukturën e një syllabusi apo program lëndor.
6. **Ciklet e leksioneve** janë materiale të thjeshta universitare që u adresohen drejtpërsëdrejti studentëve të një program studimi të cilët ndjekin ligjërata të një pedagogu të caktuar, në një lëndë/disiplinë konkrete. Temat e leksioneve në këtë rast respektojnë rigorozisht strukturën tematike të syllabusit (leksion&seminar) të lëndës konkrete, qoftë në renditje, qoftë në literaturën ndihmëse. Kjo tipologji botimi mund të jetë individuale ose me bashkëautorësi.
7. **Tekstet mësimore universitare, Monografitë dhe Ciklet e leksioneve** shkojnë për botim në ente editimi serioze dhe autoritare pasi marrin miratimin e njësisë bazë që nënkupton një diskutim të gjerë, të thellë dhe rigoroz në të cilin marrin pjesë gjithë anëtarët e saj. Ata njihen paraprakisht me tekstin e hartuar nga kolegu i tyre, marrin kohën e mjaftueshme (zakonisht jo më pak se një muaj) për t'a shqyrtuar atë dhe pas kësaj diskutojnë në një apo disa mbledhje të përbashkëta derisa teksti miratohet. Materialet e diskutimit të tekstit në fjalë ruhen me shkrim në departament.
8. **Tekstet mësimore universitare, Monografitë dhe Ciklet e leksioneve** në çdo rast duhet të dëshmojnë gjithmonë *përgjegjësitë e autorësisë dhe botimit*: emërtimin zyrtar të IAL-së, fakultetit dhe departamentit, copyright-in individual apo të përbashkët, adresën e entit botues të licensuar, adresën e entit të shtypshkrimit, redaktorinë, recenzentët (oponentët), info për design e ballinës dhe kapakut fundor, art grafik, të dhëna të qarta për autorin, katalogimin e Bibliotekës Kombëtare, ISBN, tirazhin e kopjeve të botuara, formatin (dimensionet) e tekstit, vitin e botimit, çmimin për një kopje, botimi fillestar (i parë), ribotim (botim i parë, i dytë) dhe gjithshka tjetër që parashikojnë dokumentet e Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim të librit (ISO) dhe kodit të ISBN.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

9. **Tekstet mësimore universitare, Monografitë dhe Ciklet e leksioneve** janë pronë intelektuale individuale e autorit/autorëve por dhe e universitetit ku bëjnë jetën akademike e pedagogjike.
10. Propagandimi, rekomandimi, shpërndarja dhe shitja tek studentët e materialeve universitare të shtypura që nuk respektojnë rigorozisht kërkesat shkencore, pedagogjike dhe ligjore të parashikuara në këtë udhëzim si dhe në kuadrin ligjor që mbron studentët, autorët dhe entet botuese, përbëjnë vepra penale dhe shkelje të rënda të etikës universitare të kërkimit dhe publikimit shkencor dhe si të tilla dënohen me ligj.
11. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
12. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.